



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë

PROGRAMI MËSIMOR - SYLLABUS							
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Gjuhë dhe letërsi angleze	Viti akademik	2017/18		
LËNDA		Teori e letërsisë					
Viti	I	Statusi i lëndës	Obligative	Kodi		ECTS kredi	6
Semestri	veror						
Javët mësimore	15		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtrime	
					3	2	
Metodologjia e mëimit	<p>Lënda "Teoria e letërsisë" është disiplina që merret me studimin e letërsisë si dukuri kulturore, me përkufizimin e konceptit të saj dhe me shpjegimin e metodologjive e të teknikave të leximit, të interpretimit e të analizës së teksteve letrare. Stilet dhe formacionet letrare, gjithashtu janë objekt studimi të kësaj lënde gjatë analizës së një veprë letrare dhe interpretimit të saj. Nëpërmes të kësaj lënde studiohet forma dhe përmbajtja e një veprë si tema, ideja, kompozicioni, fabula, syzheu, personazhi, tregimtari etj. Gjithashtu ajo bën klasifikimin e letërsisë në gjini dhe lloje letrare, duke i veçuar një nga një poezinë, prozën dhe dramën.</p> <p>Nëpërmjet kursit të teorisë së letërsisë studenti përfiton njohuri themelore për disa koncepte të përgjithshme, për funksionimin e instituteve letrare, për lidhjen midis tekstit e kontekstit dhe për ecuritë e komunikimit letrar.</p>						
Konsultime							
Mësimdhënësi	Prof.ass. dr. Teuta Vinca Kafexholli			e-mail	teuta.kafexholli@uni-prizren.com		
				Tel.	045 405 444		
Asistenti	Mr.sc. Artesa Osmanaj			e-mail	artesa.osmanaj@yahoo.com		
				Tel.	044 864 249		

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Qëllimi i kursit të Teorisë së letërsisë është që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të njihen me konceptet dhe me metodologjitë kryesore praktike për analizën e tekstit ▪ të njohin letërsinë si art të fjalës dhe funksionin e saj shoqërorë ▪ të njohin ç'janë orientimet letrare <ul style="list-style-type: none"> ▪ t'i kuptojnë individualizimin e pasqyrimin artistk në letërsi ▪ të njihen me rolin e invencionit si proces në krijimtarinë artistike ▪ t'i shtjellohen pikëtakimet e teorisë së letërsisë si shkencë me shkencat e tjera ▪ të mësojnë se ç'janë tema e një veprë letrare, ideja e veprës, kompozicioni dhe lidhja me karakteret. ▪ të kuptojnë gjuhën e veprës letrare, diferencimin gjuhësor të personazheve ▪ të fitojnë njohuri të përgjithshme për stilin; 	<p>Studentët do të jenë në gjendje të fitojnë njohuri:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për metodologjitë themelore të teorisë së letërsisë ▪ për objektin kryesor të teorisë së letërsisë ▪ për dallimin midis letërsisë dhe teorisë së letërsisë ▪ për letërsinë dhe për gjuhën letrare; ▪ për letërsinë dhe për rolin e shoqërisë ▪ për letërsinë si art ▪ për lidhjet e letërsisë me artet e tjera ▪ për qëllimet dhe për detyrat e studimeve letrare ▪ për shkencat e letërsisë ▪ për studimin e letërsisë si art gjuhësor ▪ për analizën e veprës letrare ▪ për strukturën e veprës letrare ▪ për eufoninë, ritmin dhe metrin ▪ për narratorin në një vepër letrare ▪ për temën, motivin dhe fabulën në veprën letrare ▪ për gjinitë letrare ▪ për epin, poezinë lirike, poemën, sonetin, romancën, baladën, nekrologjinë, esenë, romanin, dramën, poezinë dramatike, metaforën,

<p>tropet dhe figurat letrare, ritmin dhe elementet e tij</p> <ul style="list-style-type: none"> të fitojë një bazë të mirëfilltë të njohurive për studime shkencore në fushën e letërsisë. 	<p>komedinë, novelën, ironinë, etj.</p>
--	---

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:			
<p>Ligjëratat do të organizohen në modelin ndërvepruese apo të kombinuar si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtime idesh, hartime krijuese e vetëhulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjëruarit.</p>			
Kushtet për realizimin e temës mësimore:			
<p>Varësisht nga tema mund të organizohen dhe realizohen përmes komunikimit interaktiv, ligjërata në modelin klasik, përmes (kompjuterit dhe projektorit), prezantime etj.</p>			
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)			
<p>Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në, vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.</p> <p>Pikët e vlerësimit:</p> <p>Testi i parë: 10 pikë Testi i dytë: 10 pikë Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 15 pikë Punim seminari 10 pikë Vlerësimi i fundit testi përfundimtar 55 pikë. Totali: 100 pikë</p>	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	
	100% - 91%	10 (dhjete)	
	90% - 81%	9 (nëntë)	
	80% - 71%	8 (tetë)	
	70% - 61%	7 (shtatë)	
	60% - 51%	6 (gjashtë)	
50%	5 (pesë)		
<p>Obligimet e studentit: Të jetë pjesëmarrës aktiv, t'i kryej seminare; prezantimet dhe hulumtimet e pavarura. Gjatë ligjëratave nuk i lejohet komunikimi me telefon apo modele të tjera të cilat pengojnë procesin e mësimin. Gjatë organizimit të testeve nuk lejohet kopjimi, komunikimi apo ardhja më vonë, sepse do të pengojnë procesin mësimor.</p> <p>Testet apo provim organizohet sipas plan-programit të paraparë dhe zgjatë një orë mësimore.</p>			
Ligjërata	Ushtrime		
<p>Në ligjërata studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore, dhe studimore për ta kuptuar dhe realizuar temën e dëgjuar apo plan-programin e lëndës.</p>	<p>Brenda orëve të ushtrimeve dhe me metoda ndërvepruese do të ketë pjesë të ushtrimeve për qartësi më të madhe që kanë të bëjnë me lëndën Teori e letërsisë.</p>		
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	3	15	45
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	15	15
Seminare, teste, kolokfiume etj.	4	2	8
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final)	4	2	8
Projekte, prezantimet etj.	1	3	3
Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		Ngarkesa totale:	150

Java	Ligjërata	Ushtrime		
1.	Tema	Orët	Tema	Orët
	Hyrje në lëndën e Teorisë së letërsisë Zanafilla e teorisë së letërsisë; Pikëtakimet e shkrimeve letrare me shkrimet tjera; Shkenca e studimit të letërsisë (degët) .	3	Zhvillimi i teorisë së letërsisë; Me se merret teoria e letërsisë?	2
2.	Teoria dhe letërsia Karakteret sinkretik të artit në lashtësi; Teoria e letërsisë si disiplinë; shkencore dhe si domosdoshmëri për të interpretuar fenomenet letrare.	3	Mendimet e dijetarëve të ndryshëm për llojet e arteve; Klasifikimi i arteve sipas Platonit; Përpunimi i tipologjive letrare sipas Aristotelit.	2
3.	Letërsia, art i fjalës Ç'është letërsia?; Teoria e Platonit mbi mimezisin; Ligjërimi artistik i letërsisë; Letërsia dhe gjuha.	3	Cilit lloj të artit i përket letërsia; Ç'vend zë ajo në mesin e arteve të tjera?; Ç'raport ka ajo me shkencën?	2
4.	Shkenca e letërsisë Objekti i studimit të shkencave të letërsisë; Historia e letërsisë nacionale, krahasimtare, e përgjithshme; Gjuha poetike dhe rëndësia e saj sipas Aristotelit; Orijentimet e reja në zhvillimin e teorisë së letërsisë në shek. XX, që konsiderohen të rëndësishme për letërsinë.	3	Pikëpamjet teorike të mendimtarëve të shek. XVIII, XIX për shkenca të letërsisë; Historia e letërsisë si degë e shkencës së letërsisë e cila merret me studimin e letërsisë në rrjedhën e saj historike; Kritika letrare, degë e shkencës së letërsisë e cila merret me vlerësimin dhe gjykimin e vlerave letrare të veprës artistike.	2
5.	Retorika dhe stikistika Përcaktimi i stilit në shkencën bashkëkohore; Ndarja e stilit në retorikën e vjetër: stili i ulët, i mesëm dhe i lartë.	3	Përcaktimi i stilit në periudha të ndryshme; Mendimet e autorëve të ndryshëm për stilin në përgjithësi.	2
6.	Figurat stilistike Përcaktimi i stilit dhe studimi i tij si pikë qendrore e studimit në aspektin e përgjithshëm.	3	Figurat stilistike; Figurat tingullore; Figurat e fjalorit; Figurat e fjalës (tropet); Figurat e sintaksës; Figurat e kuptimit.	2
7.	Metrika Sistemet e vargëzimit; Vargu i lirë dhe ritmi; Rima; Strofa; Trajtat strofike; Vargëzimi shqip.	3	Studimi metrik; Sistemi metrik; Sistemi silabik; Sistemi tonik.	2

8.	Klasifikimi i letërsisë. Natyra e lirikës dhe struktura e saj Poezia dhe figura; Elementet e poezisë; Llojet e poezisë lirike; Lirika sipas tematikës Lirika metafizike dhe e estetizmit; Lirika moderne, balada; Poezia satirike; burleska, parodia.	3	Gjinitë dhe llojet letrare; Imazhi poetik; Struktura e brendshme e poezisë.	2
9.	Poezia epike Poezia epike dhe narrator; Digresionet brenda veprës epike; Rrjedha kryesore e veprimit dhe tërësia e mëvetëshme dhe tërësi e rrumbullakësuar; Epi i shkruar dhe epi gojor: dallimet dhe përkimet.		Dallimet mes poezisë lirike dhe epike; Llojet e poezisë epike; Vepra e Homerit, themel i zhvillimit të epikës, që nga antika e deri më sot.	2
10.	Drama. Kuptimi i artit dramatik Fillimet e dramës në letërsinë antike Llojet e dramës; Elementet e dramës.	3	Drama dhe llojet e saj Elementet e dramës; Krijuesit e tragjedyve antike; Disa lloje të veçanta të dramatike Përbërja e shatë pjesëve kryesor të dramës, të cilat përbëjnë etapat (fazat) përmes të cilave kalon veprimi dramatik.;	2
11.	Letërsia narrative Proza si vazhdim i drejtpërdrejtë i epit; Format kryesore të prozës: romani, novela, tregimi; Monologu i brendshëm në prozën moderne.	3	Proza dhe llojet e saj Proza e mirëfilltë artistike, dhe disa lloje të tjera të cilat qëndrojnë midis veprës artistike e shkencore.	2
12.	Analiza e veprës letrare Analiza filologjike; Teoria filologjike; Tema e veprës letrare; Fibula, syzheu, konflikti; Kompozicioni i veprës letrare; Ideja e veprës letrare.	3	Analiza e strukturës së veprës letrare; Narratori dhe identifikimi me tekstin.	2
13.	Arti i filmit si arritje e madhe e shekullit XX Struktura e filmit; Skena, sekuenca, dialogu, nënteksti.	3	Zhanret e filmit; Sinopsisi - përmbledhje narrative e tregimit të filmit; Karakterizimi i heroit.	2
14.	Rrymat letrare avangarde të shekullit XX Teoricientët e futurizmit; Surrealizmi; Ekspressionizmi; Dadaizmi.	3	Lindja e këtyre rrymave si reagim estetik i rrymave paraprake letrare; Futurizmi si lëvizje letrare që pati ndikim edhe në artet e tjera si në pikturë, arkitekturë, teatër, skenografi, balet dhe muzikë.	2
15.	Teoria prej modernes deri sot Qasja natyraliste e teorive moderne mbi	3	Teoria në kohën moderne dhe mendimi evropin.	2

	artin poetik; Tradita dhe zhvillimi i studimeve teorike; Mendimet letrare sipas metodës strukturaliste.			

LITERATURA
<p>Literatura bazë: Zejnullah Rrahmani, <i>Teoria e letërsisë</i>, Prishtinë 2008. René Vellek dhe Austin Voren: <i>Teoria e letërsisë</i>, Tiranë 2007. Aristoteli, <i>Poetika</i>, Rilindja, Prishtinë, 1968.</p> <p>Literatura shtesë: Tvetan Todorov. <i>Poetika e prozës</i>, Tiranë. 2000. P.Tevo & Zh.Lekomt, <i>Komenti letrar</i>, Tiranë, 2000. Floresha Dado, <i>Teoria e veprës letrare – Poetika</i>, Tiranë, 2003. Milivoje Solar, <i>Hyrje në shkencën për leterësinë</i>, Tiranë 2004. Xhonatan Kaller <i>Teori letrare</i>, Prishtinë, 2001.</p>
VËREJTJE
<p>Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.</p>

Vërejtje për studentin:
<p><i>Studentët duhet t’u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së, rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor Pritet që secili student të vijë me kohë dhe të marrë pjesë në çdo ligjeratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së studimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t’i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.</i></p>